



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1811 Prot.

Tiranë më 21. 10 2022

REKOMANDIM

Nr. 33, datë 21. 10 2022

MBI
RESPEKTIMIN E DETYRIMEVE LIGJORE NË KUADËR TË MBROJTJES
SË TË DHËNAVE PERSONALE NË SEKTORIN E SHËRBIMIT TË
NOTERISË

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31, pika 1 gërma a/1, dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), në kuadër të mbikëqyrjes së aktivitetit të Kontrolluesve në sektorin e shërbimit të noterisë, në përmbushje të respektimit të parimeve dhe detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, me qëllim disiplinimin dhe sensibilizimin e këtij sektori,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), ka realizuar hetime administrative për mbikëqyrjen e proceseve përpunuese nga Kontrolluesit në sektorin e shërbimit të noterisë, me qëllim verifikimin e respektimit të parimeve dhe kriterëve ligjore të parashikuar në nenet 5 dhe 6 të Ligjit si dhe garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave parashikuar në nenet 27 dhe 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit ka vërejtur gjatë kësaj periudhe një shqetësim në rritje të subjekteve të të dhënave (qytetarë) lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave të tyre personale, si dhe sigurinë dhe ruajtjen e konfidencialitetit të tyre, nga Kontrolluesit në sektorin e shërbimit të noterisë.

Ky shqetësim është konstatuar qoftë në kuadër të ankesave të paraqitura nga subjektet e të dhënave pranë Zyrës së Komisionerit, por edhe në indicie të publikuara në media të ndryshme, lidhur me pretendime për përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale, referuar çertifikatave të gjeneruara nëpërmjet sistemit të e-Albania.

Referuar pikës 12 të nenit 3 të Ligjit “Përpunim i të dhënave personale është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash.”

Nisur nga rëndësia e këtyre të dhënave si dhe nga fakti se, që prej datës 01.05.2022, çdo shërbim i administratës publike do të përfitohet vetëm nëpërmjet sistemit e-Albania, ka sjellë si nevojë monitorimin e vazhdiesshëm të proceseve përpunuese të të dhënave personale nga Kontrolluesit dhe përpunuesit në fushën e noterisë dhe një vëmendje të shtuar nga ana e Zyrës së Komisionerit, në kuadër të garantimit të sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave, si dhe parimeve ligjore dhe të drejtave të subjekteve të të dhënave.

Krahas dispozitave të sipërpërmendura të Ligjit, hetimet administrative janë bazuar edhe në parashikimet detyruese të akteve nënligjore të nxjerra nga Zyra e Komisionerit në zbatim të Ligjit, dhe më specifiku në Udhëzimin e përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020 të Ministrisë të Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin” (në vijim, “Udhëzimi nr. 463”).

Qëllimi i këtij Udhëzimi, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2021, pas publikimit në Fletoren Zyrtare, është përcaktimi i institucioneve të cilat duhet të kenë akses në Regjistrin e Gjendjes Civile si dhe llojit dhe sasisë së informacionit që duhet të marrin në këtë regjistër.

Ndër subjektet kontrolluese që mund të marrin të dhëna në Regjistrin e Gjendjes Civile, janë edhe Noterët, të cilët marrin të gjitha të dhënat e domosdoshme për çeljen e trashëgimisë sipas përcaktimeve të ligjit, në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.

Në kuadër të verifikimit të ankesave të paraqitura nga qytetarët, nëpërmjet të cilave pretendojnë se janë njoftuar me një mesazh në llogarinë e tyre në platformën e-Albania se: “Punonjësi (emër, mbiemër) i Dhomës Kombëtare të Noterëve ka gjeneruar dokumentin.....”, por edhe interesit të madh që ka patur në media, Zyra e Komisionerit ka ndërmarrë iniciativën e disa hetimeve administrative pranë Noterëve, në cilësinë e Kontrolluesve, si dhe pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, që mban njëherazi cilësinë e kontrolluesit dhe të autoritetit që përfaqëson dhe mbron interesat e noterëve shqiptarë. Dhoma Kombëtare e Noterëve është person juridik, me statusin e organizatës profesionale, anëtarësia në të cilën është e detyrueshme për të gjithë noterët. Dhoma Kombëtare e Noterëve përfaqëson bashkimin e të gjithë noterëve dhe zëvendësnoterëve, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Dhoma

Kombëtare e Noterëve përfaqëson dhe mbron interesat e noterëve dhe zëvendësnoterëve shqiptarë, që ushtrojnë veprimtarinë dhe funksionet e tyre noteriale, duke siguruar në çdo rast mbrojtjen e të drejtave sociale dhe profesionale të tyre.

Në vijim do të listohen disa nga problematikat e konstatuara gjatë hetimeve administrative të ushtruara pranë këtyre Kontrolluesve:

1. Në mbështetje të Rregullores nr. 6432, datë 15.11.2018 të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (në vijim, "AKSHI") "*Për funksionimin e modulit të portalit e-Albania*", si dhe Marrëveshjes me nr. 1641 prot., datë 13.12.2017, nënshkruar midis Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe AKSHI-t "*Për shërbimet publike elektronike në portalin unik qeveritar e-Albania*", është dhënë akses për punonjësit e autorizuar të institucioneve publike dhe noterëve të Dhomës Kombëtare të Noterëve, në Modulin e Administratës Publike, për gjenerimin e dokumenteve elektronike shoqëruese, përmes portalit e-Albania, në kuadër të ofrimit të shërbimeve publike.

Njëkohësisht, edhe në Udhëzimin nr. 463 të sipërcituar, përcaktohet se, Noterët, mund të marrin të dhëna në formën shkresore ose elektronike nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile për nevoja të çeljes së trashëgimisë, si një e drejtë kjo që buron nga Ligji nr. 110/2018 "*Për noterinë*", i ndryshuar (në vijim "*Ligji nr. 110/2018*"), konkretisht neni 125 "*Tërheqja e akteve të gjendjes civile pranë zyrave të gjendjes civile nga noteri dhe aplikimi nëpërmjet sistemit*".

Në vijim të Marrëveshjes së sipërcituar secilit noter, për ushtrimin e veprimtarisë së tij i është mundësuar akses i përmes modulit të Administratës Publike, në portalin e-Albania, me qëllim verifikimin e të dhënave përgjatë përpilimit/kryerjes së veprimit/aktit noterial, për çeljen e trashëgimisë sipas përcaktimeve ligjore. Konkretisht, Noteri, në zbatim të neneve 62 dhe 63 të Ligjit nr. 110/2018, me paraqitjen e klientit për kryerjen veprimit noterial, për nevoja të përmbushjes së detyrave të tij, akseson në llogarinë e tij në portalin e-Albania.

Paralelisht, në zbatim të nenit 96 të Ligjit nr. 110/2018, noteri për tërheqjen e informacionit të nevojshëm për hartimin e aktit apo veprimit noterial, aplikon nëpërmjet sistemit elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterëve (NISA), pranë Zyrës së Gjendjes Civile, Regjistrat Publik të Pasurive të Paluajtshme, Regjistrat të Barrëve Siguruese, Drejtorisë së Përgjithshme të Regjistrimit të Automjeteve, si dhe regjistra të tjerë publik. Në mbështetje të kësaj dispozite, me VKM nr. 1045, datë 15.01.2020, "*Për mënyrën e ndërlikjes, nivelin e aksesit dhe të bashkëveprimit të sistemit elektronik të dhomës kombëtare të noterisë me bazat e tjera të të dhënave*" janë përcaktuar konkretisht, regjistrat si dhe kategoritë e të dhënave që do të përthithen nga këto regjistra në sistemin NISA.

Në llogarinë e tij në portalin e-Albania noterit i shfaqen gjithsej 26 shërbime elektronike, në të cilat u është mundësuar akses i për të lexuar dhe gjeneruar

certifikatat në përmbajtje të secilit shërbim elektronik. Këto shërbime i përkasin konkretisht shërbimeve të ofruara nga institucionet: Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (aktualisht Agjencia Shtetërore e Kadastrës), Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC), Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT).

Midis llojeve të certifikatave/dokumenteve që mund të gjenerohen përmes këtij moduli, janë edhe disa dokumente si: *Vërtetimi i Pensionit që gjenerohet nga databaza e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Karta e Shëndetit që gjenerohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Vërtetim për lejen e drejtimit që gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, Vërtetim për pagimin e kontributeve për individin nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve etj.*

Nga shqyrtimi i bazës ligjore specifike që rregullon veprimtarinë në sektorin e shërbimit të noterisë konstatohet se nuk ka një parashikim ligjor që të legjitimojë aksesin e noterëve në shërbimet elektronike të sipërcituara, të cilat ofrohen përmes modulit të administratës publike në portalin e-Albania. Për rrjedhojë, aksesin e dhënë noterëve në portal për këto shërbime nga AKSHI, është në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë të sanksionuar në nenin 5, dhe kriteret ligjore për përpunimin të sanksionuara në nenin 6 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo Kontrollues, ka të drejtën dhe detyrimin që të përpunojë ato të dhëna që janë të nevojshme për të realizuar qëllimin duke respektuar në këtë mënyrë një nga parimet e mbrojtjes së të dhënave personale siç është mjaftueshmëria e të dhënave, sanksionuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit, në të cilin parashikohet se mbledhja dhe përpunimi i të dhënave duhet të lidhet me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.

Në këtë kuadër, me qëllim kufizimin e përpunimit të mëtejshëm të të dhënave personale në tejkallim të parimit të mjaftueshmërisë, Dhoma Kombëtare e Noterëve, me statusin e organizatës profesionale ku anëtarisimi është i detyrueshëm, dhe që përfaqëson bashkimin e të gjithë noterëve dhe zëvendësnoterëve si dhe mbron interesat e noterëve shqiptarë, duhet të marrë sëbashku me AKSHI-n, që aksesin në portalin e-Albania të kufizohet vetëm në ato të dhëna të cilat lidhen ngushtësisht me qëllimin specifik të përpunimit, duke mos tejkaluar qëllimin për të cilin është mundësuar ky akses.

2. Mbas hyrjes në fuqi të Vendimit nr. 252, datë 29.4.2022 “*Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre*”, sipas fushëveprimit të këtij akti nënligjor, aplikimet për shërbimet e të gjithë institucioneve shërbimofruese, kryhen nëpërmjet portalit e-Albania dhe duhet të realizohen vetëm elektronikisht, duke siguruar lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike

ose nënshkrim elektronik. Pra, çdo qytetar për përfitimin e një dokumenti nga një institucion shërbimofruës, duhet ta bëjë aplikimin vetëm nëpërmjet portalit e-Albania.

Në kushtet kur qytetarëve, në mënyrë të vazhdueshme, iu nevojiten dokumente që më pas të adresojnë kërkesat e tyre pranë noterëve për përpilimin e akteve të ndryshme noteriale, për lehtësim të këtij procesi, ata në disa raste i drejtohen vetë noterit për të shkarkuar dokumentacionin e tyre personal nga portali e-Albania.

Vlen të theksohet se një praktikë e tillë nga ana e noterit, edhe pse në interes dhe ndihmë të qytetarit, bie ndesh me parimin e përpunimit të të dhënave në përputhje me qëllimin, pasi noterit nuk i është dhënë akses në portalin e-Albania, për të zëvendësuar sportelin fizik dhe të lëshojë dokumente për qytetarët, të cilët janë të pajisur me llogaritë e tyre personale, por për të lehtësuar veprimtarinë e tij noteriale. Përpunimi në çdo rast nuk mund të tejkalojë qëllimin e kësaj veprimtarie duke u shndëruar në sportel fizik.

Mirëpo, në rastet kur nga ana e noterit kryhen veprime në portalin e-Albania, në interes të një qytetari (*psh: shkarkohet një dokument nga e-Albania pas kërkesës për çeljen e trashëgimisë*) për çdo dokument të gjeneruar nga noteri, qytetarit për të cilin është gjeneruar dokumenti, në llogarinë e tij në këtë portal, në rubrikën “*Mesazhet e mia*”, i dërgohet një njoftim ku specifikohet dokumenti i gjeneruar, emri i noterit që e ka gjeneruar dokumentin, si edhe autoritetit/institucioni që e ofron këtë shërim apo lëshon këtë dokument.

Problematika që konstatohet në këtë rast është garantimi i detyrimit për informim, nga ana e këtyre Kontrolluesve (noterëve) përkundrejt trashëgimtarëve testamentare ose ligjorë, të cilët nuk janë paraqitur vetë pranë noterit për të kërkuar lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, por janë pjesë e trungut familjar të trashëgimlënësit, pasi edhe ata marrin dijeni në adresën e tyre elektronike për dokumentin e gjeneruar, ndërkohë që nuk informohen për qëllimin e përpunimit të të dhënave të tyre, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit, vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbyshja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Dhoma Kombëtare e Noterëve, në cilësinë e autoritetit që përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të shërbimit noterial në Republikën e Shqipërisë, në bashkëpunim me AKSHI-n duhet të marrë masa për rishikimin e modulit informues (*në lidhje me rubrikën “Mesazhet e mia” në portalin e-Albania*), duke integruar në këtë rubrikë një hapësirë në të cilën noterët të hedhin informacionin e nevojshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 18 të Ligjit, me qëllim që të garantojnë detyrimin

për informim në mënyrë shteruese të subjekteve të të dhënave, për qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat si dhe për mënyrën e përpunimit në çdo rast aksesit në të dhënat e tyre.

3. Një problematikë e konstatuar, për të cilën ka pasur ankesa edhe nga vetë Noterët, pranë Dhomës Kombëtare të Noterëve, lidhet me mbylljen e aksesit të noterëve në këtë portal. Pra, sipas deklarimeve të Dhomës Kombëtare të Noterëve si dhe provave të administruara, pas paraqitjes në adresë të AKSHI-t të ankesave nga ana e qytetarëve, me pretendimin se janë gjeneruar dokumente nga portali e-Albania pa pëlqimin e tyre, nga ana e AKSHI-t bëhet një vlerësim rast pas rasti të secilës ankesë, dhe më pas në disa raste procedohet me mbylljen e aksesit përkundrejt atij/asaj noteri/notereje. Parashikimin e kësaj kompetence, AKSHI e ka përfshirë në pikën 3.2.5 të nenit 3, të Marrëveshjes nr. 1641 prot., datë 13.12.2017, midis Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe AKSHI-t. Konkretisht, sipas kësaj pike përcaktohet se, AKSHI, si administrator i portalit ka detyrë të monitorojë dhe kontrollojë përdorimin e portalit nga ofruesit e shërbimit për të tretë dhe të marrë masa deri në mbylljen e aksesit në portal të këtyre të fundit.

Ky fenomen ka sjellë si pasojë ankesa të shumta nga ana e noterëve drejt Dhomës Kombëtare të Noterëve, për mbylljen e aksesit në portalin e-Albania, pasi mbas hyrjes në fuqi të Vendimit nr. 252, datë 29.4.2022 *“Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”* për noterët është e pamundur tërheqja e këtyre dokumenteve/certifikatave fizikisht, në Zyrat e Gjendjes Civile.

Mbyllja e aksesit sjell si pasojë pengesa në ushtrimin e veprimtarisë së Noterit, pasi verifikimi i përbërjes së trungut familjar/gjendjes familjare, është një veprim i domosdoshëm në momentin e çeljes së trashëgimisë apo në rastet e kalimit të të drejtave të pronësisë. Mirëpo sipas nenit 125 të Ligjit nr. 110/2018 rezulton se, noteri ka të drejtë të bëjë kërkesë pranë zyrave të gjendjes civile përkatëse ose të caktojë persona të autorizuar prej tij, për të tërhequr çdo lloj certifikate të nevojshme për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare ose ligjore.

Lidhur me sa më sipër konstatojmë së pari se Marrëveshja e cituar më lart ka qenë e vlefshme deri në datën 31.12.2018.

Gjithashtu konstatohet se kompetenca që i është veshur AKSHI-t në pikën 3.2.5 të nenit 3 të Marrëveshjes krijon mbivendosje me kompetencat ligjore të Komisionerit për të Drejtën e Infomimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale sipas Ligjit nga njëra anë dhe me ato të Bordit Disiplinor sipas Ligjit nr. 110/2018 nga ana tjetër, duke shkaktuar në këtë mënyrë pasiguri juridike.

Konkretisht sa i takon bllokimit dhe/ose pezullimit të përpunimit të të dhënave personale, autoriteti i vetëm që legjitimohet në bazë të nenit 30, pika 1, germa (b) e

Ligjit, për të urdhëruar bllokimin dhe/ose pezullimin e përpunimit në rastet e konstatimit të përpunimit e paligjshëm të të dhënave personale, nga kontrolluesi, është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky veprim (pra bllokimi dhe/ose pezullimi i përpunimit) vjen si rezultat i një procedure të qartë dhe të mirëpërcaktuar në Ligj e cila garanton transparencë për palët e përfshira në proces.

Nga ana tjetër, ndërprerja e aksesit për noterët në portalin e-Albania, në kushtet kur tërheqja e dokumenteve fizikisht është e pamundur, sjell praktikisht si rezultat pezullimin e veprimtarisë së noterit, duke u mbivendosur kështu me kompetencat e Bordit Disiplinor, që është autoriteti i vetëm që mund të marrë masa disiplinore për noterët.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Dhoma Kombëtare e Noterëve duhet të marrë masa për rinovimin e Marrëveshjes, si dhe rishikimin e të drejtave dhe të detyrimeve të palëve të përfshira në të, duke marrë në konsideratë parashikimet/kufizimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe legjislacioneve respektive, me qëllim orientimin e këtij bashkëpunimi, në përputhje me parashikimet ligjore, si dhe duke mos i tejkaluar kompetencat ligjore të secilit autoritet.

4. Lidhur me “*Deklaratën Personale të Aplikuesit*” apo “*Deklaratën e Pëlqimit*” e cila i kërkohet palës përpara se noteri të aksesojë dhe të gjenerojë dokumentacionin e kërkuar në portalin e-Albania, konstatohet nga verifikimet se, Noterët nuk aplikojnë formatin standard të miratuar të “*Deklaratës së Pëlqimit*”, e cila është në formën e një deklarate me shkrim e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij, sipas pikës 24, të nenit 3 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, duke mbajtur në konsideratë kërkesat e pikës 24 të nenit 3, i cili përcakton se, *Pëlqimi* i subjekteve të të dhënave është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij.

Dhoma Kombëtare e Noterëve, në cilësinë e autoritetit kompetent për njehsimin e praktikave noteriale, duhet të marrë masa që noterët dhe zëvendësnoterët, të përdorin një format standard të Deklaratës së pëlqimit, duke ju referuar modelit të përcaktuar në Aneksin 3, të Udhëzimit nr. 463. Kjo “*Deklaratë Pëlqimi*” duhet të përdoret në mënyrë në uniforme nga të gjithë noterët dhe zëvendësnoterët përpara se të përpunojnë të dhënat personale të subjektit të të dhënave me qëllim që të jetë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Udhëzimin nr. 463.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se në total kanë plotësuar detyrimin

ligjor për të “*Njoftuar*” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat janë përgjegjës, vetëm 46 Noterë të cilët kanë licencë aktive, për të ushtruar veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë, si dhe dy prej Degëve Vendore të Noterisë. Ndërkohë bazuar në listën e publikuar nga Dhoma Kombëtare e Noterëve rezulton se janë aktualisht 451 Noter si dhe 6 Degë Vendore të Noterisë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për njoftim dhe përditësimi i “*Formularit të Njoftimit*” është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin e të dhënave që kryen kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji. Mospërbushja e detyrimit për njoftim përbën shkelje të neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Përditësimi ka të bëjë me faktin se detyrimi për njoftim nuk mund të konsiderohet i përfunduar dhe i pandryshueshëm në kohë, por ekziston në çdo rast kur ndryshon një nga elementët e “*Formularit të Njoftimit*”. Kontrolluesit kanë detyrimin për të përditësuar njoftimin sa herë që ndryshon gjendja e njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të Ligjit, të njoftuar më parë. Dhoma Kombëtare e Noterëve, si dhe të gjithë Noterët duhet të marrin masa për përbushjen e këtij detyrimi sipas neneve 21, 22 të Ligjit.

6. Kontrolluesit disponojnë Rregullore “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, por konstatohet se, përmbajtja e tyre është e kufizuar dhe nuk reflekton detyrimet ligjore, sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon Kontrolluesi, kategorive të subjekteve të të dhënave në referim të parimeve ligjore dhe rregullave specifike të parashikuara në udhëzimet specifike të miratuara nga Komisioneri, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një “*Rregullore specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shpesh pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Detyrimi për përpilimin e një rregulloreje specifike për mbrojtjen e të dhënave personale, rëndon mbi Dhomën Kombëtare të Noterëve si dhe të gjithë Noterët, në cilësinë e Kontrolluesve.

Zyra e Komisionerit thekson se nevojitet një angazhim serioz i Kontrolluesve dhe Përpunuesve në sektorin e shërbimit të noterisë, me qëllim përbushjen e detyrimit ligjor për informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe garantimin dhe respektimin e të drejtave të tyre, në lidhje me marrjen e masave tekniko-organizative për sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, në përputhje me Ligjin.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 21, 22, 27, 29, 30, 31 pika 1, germa “a/1”, si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Dhoma Kombëtare e Noterëve, të përcaktojë në mënyrë të qartë databazat në të cilat legjitimohet të ketë akses çdo Kontrollues në sektorin e shërbimit të noterisë dhe kategoritë e të dhënave që duhet të aksesojë në secilën databazë, si dhe të marrë masa të menjëhershme, sëbashku me AKSHI-n, në drejtim të ndalimit të aksesit të paligjshëm nga ana e Noterëve, në ato databaza, aksesit në të cilat, është në tejkalim të parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave, sipas parashikimit në germën “c” të pikës 1, të nenit 5 si dhe në përputhje me kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave të sanksionuara në nenin 6 të Ligjit;
2. Dhoma Kombëtare e Noterëve, të marrë masa për rishikimin/rimodelimin e modulit informues, për përpunimin e të dhënave në portalin e-Albania, bazuar në përcaktimet e nenit 18 të Ligjit;
3. Dhoma Kombëtare e Noterëve, duhet të marrë masa për rinovimin e Marrëveshjes me nr. 1641 prot., datë 13.12.2017, me qëllim rishikimin e të drejtave dhe të detyrimeve të palëve të përfshira në të, duke marrë në konsideratë parashikimet/kufizimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale;
4. Dhoma Kombëtare e Noterëve, duhet të marrë masa për përpilimin e modelit standard të “*Deklaratës së Pëlqimit*”, sipas pikës 24, të nenit 3 të Ligjit, e cila më pas duhet të aplikohet në mënyrë standarde nga të gjithë Noterët;
5. Në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të plotësohet detyrimi për njoftim nga Kontrolluesit në sektorin e shërbimit të noterisë, të cilët nuk e kanë zbatuar këtë detyrim për herë të parë, si dhe të tregohet kujdes në vijimësi, në përditësimin e njoftimit për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit, të njoftuar më parë;
6. Kontrolluesit në sektorin e shërbimit të noterisë, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të hartojnë “*Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
7. Dhoma Kombëtare e Noterëve, në cilësinë e autoritetit që përfaqëson dhe mbron interesat e noterëve shqiptar, duhet të marrë masa për të përmbushur dhe adresuar drejt të gjithë Kontrolluesve dhe përpunuesve, të këtij sektori në rolin e saj mbikëqyrës, detyrimet rekomanduese të dala nga ky akt i Komisionerit, brenda afatit kohor 60 (gjashtëdhjetë) ditor, duke filluar nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

8. Të njoftohet me shkrim pranë Zyrës së Komisionerit mbi masat e marra në zbatim të Rekomandimit të mbështetura nga veprimet përkatëse. Plotësimi i këtij detyrimi ligjor mund të jetë edhe objekt hetimi administrativ në të ardhmen;
9. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 21. 10.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

